



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr. 743/2

Gramsh, më 02/03/2023

Vendim

Nr. 13, dt. 28.02.2023

Për

Për miratimin e shumës së bashkëfinacimit të subvencionimit të qerasë

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës 28 02.2023, pasi mori në shqyrtim relacionin e drejtorisë së Shërbimeve me Sipërmarrje, Transporteve, Strehimi dhe Emergjencave Civile si dhe drejtorisë së Financës dhe Buxhetit "Për miratimin e shumës së bashkëfinacimit të subvencionimit të qerasë", në mbështetje të ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 "Për strehimin social", në VKM nr.459, datë 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirës ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për strehimin", në Udhëzimin e MFE, nr.31, dt.18.11.2019, "Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, pika 2;

Vendosi:

- I.** Të miratohet shuma e bashkëfinacimit për subvencionimin e qirasë në masën **662 464** (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e gjashtë dhjetë e katër) lekë, për 30 familje në nevojë bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh me qëllim përfitimin e fondeve buxhetore.
- II.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë, drejtorja e shërbimeve publike dhe emergjencave civile, drejtorja e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë
Xhulia GJINI

Konc. Xh. Gjini
Konf. G. Lena
Dosja: _____
Afati: _____

Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Greta LENA

